



BalkanSport shpk, distributori zyrtar i markave të mirënjohura sportive si **adidas**, **Reebok**, **Head**, **Mares** dhe **Givova** për Shqipërinë; dhe gjithashtu përfaqësues zyrtar i rrjetit multibrand sportiv **INTERSPORT** dhe **The Athlete's Foot**, ofron **Internship** për kandidatët e interesuar në pozicionin:

Assitent/e Finance

Asistenti/ja e Financës është pjesë e departamentit të Financës, raporton tek Menaxheri i Financës. Asistenti/ja në Financë kujdeset për të dhënat financiare. Përgjegjësitë e Asistentit/es në Financë përfshijnë grumbullimin dhe futjen e të dhënave në bazat e të dhënave dhe mbajtjen e shënimeve të sakta të informacionit të vlefshëm për kompaninë.

Roli dhe Përgjegjësitë:

- Regjistrimi i faturave të shitjeve dhe blerjeve në sistemin e financës.
- Hedhja dhe kontrolli i veprimeve me bankat dhe arkën në sistemin financiar, kontaktet me bankat për çdo problem, pagesë dhe detyrim.
- Rakordim klientë – furnitorë dhe ndjekja e detyrimeve dhe të drejtave sipas afateve të caktuara.
- Përpunimi i formatit të doganës për furnizimet dhe hedhja në sistemin financiar. Rregjistrimi në system i deklarates doganore. Përpunimi i packing list tw furnizimeve.
- Ndjekja ditore e problemeve që mund të kenë dyqanet në lidhje me POS-et, me programin financiar, programin e kartave të klientëve dhe skanerave.
- Deklarim i librave të shitjes/blerjes, FDP-së, e deklaratave të tjera tatimore në mënyrë periodike në sistemin online të tatimeve. Deklarimin në sistemin tatimor on line të punësimeve dhe largimve të punojsve.

Aftësitë:

- Të jetë korrekte, e shkathët dhe e aftë për të përballuar volumin dhe ngarkesën në punë.
- Të ketë bashkëpunim me stafin në lidhje me mbarëvajtjen e punës.
- E mirëorganizuar dhe e orientuar nga detajet, në gjendje të punojë nën presion dhe njëkohësisht në disa punë, aftësi të forta ndërpersonale dhe një qëndrim pozitiv.
- Të ketë aftësi të shkëlqyera komunikimi, fleksibilitet dhe sjellje e paraqitje etike.

Edukimi dhe Kualifikimet:

- Diplomë Bachelor ose Master në Administrim Biznesi, Financë ose Informatikë Ekonomike.
- Ekperiencë pune në këtë profil ose të ngjashëm përbën avantazh.
- Njohuri të programeve finaciari, si: Financa5, Alpha
- Të jetë njohës shumë i mirë i Excel-it dhe programeve kompjuterike.

Pas përfundimit me sukses të Intership-it (praktikës) dhe vlerësimit të performancës ofrohet mundësia e punësimit pranë kompanisë.

Kandidatët e interesuar për pozicionin e mësipërm, duhet të dërgojnë CV-në deri më,
datë **30 Qershor 2020** në adresat e-mailit: hr@balkansport.al

Balkan Sport HR Team